



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
30.05.2023			
Prishta Org. Org. Unit	Stat.Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No.	Nr. faqevë Br. Stranica No. Pages
05	47	835	1

PK. SH.A. Posta e Kosovës SH.A. Post of Kosovo J.S.C. Pošta Kosova D.D.			
30-05-2023			
Pranuar: dimitri B. Krasniqi	Numer Number Broj	Shtojca Attached Prilog	Vlera Value Vrednost
	01-	1334	/23


Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

<b>Për:</b>	Fadil Bejta, Kryesues i Bordit të Postës së Kosovës sh.a. Nora Rraci, Kryeshef Ekzekutiv i Postës së Kosovës sh.a. Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
<b>Kopje elektronike:</b>	Hykmete Bajrami, Kryesuese e KMFP Armend Muja, Kryesues i KBPT Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë Adem Ahmetaj, Udhëheqës i Njësisë për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
<b>Nga:</b>	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
<b>SUBJEKTI:</b>	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Postës së Kosovës sh.a për vitin 2022

<b>Nr. Zyrës:</b>	<b>Ext:</b>	<b>Data:</b> 30.05.2023
-------------------	-------------	-------------------------

Data	Zyra e Pranimi	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Postës së Kosovës sh.a për vitin 2022.  Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzojë një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.		



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

<b>Za:</b>	Fadil Bejta - Predsendnik Upravnog Odbora Pošte Kosova o.d. Nora Rraci - Glavni Izvršni Direktor Pošte Kosova, o.d. Glauk Konjufca - Predsednik Skupštine Republike Kosovo
<b>Elektronski primerak:</b>	Hykmete Bajrami, Predsednik KNJF Armend Muja, Predsednik KBRT Artane Rizvanolli, Ministarka Ekonomije Adem Ahmetaj, Zamenik Rukovodilac Jedinice za Monitoring Javnih Preduzeća
<b>Od:</b>	Vlora Spanca, Generalna Revizorka Republike Kosovo <i>Spanca</i>
<b>PREDMET:</b>	Izveštaj revizije za godišnje finansijske izveštaje Pošte Kosova za 2022


<b>Br. Kancelarije:</b>	<b>Ext:</b>	<b>Datum:</b>	30.05.2023
-------------------------	-------------	---------------	------------

Datum	Prijemna kancelarija	Komentari/Radnje	Inicijali	Rok
		U prilogu možete pronaći Izveštaj revizije za godišnje finansijske izveštaje Pošte Kosova za 2022 godinu.  Prema članu 23, stav 5 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnom Kancelariju Revizije, svaka revidirana institucija je obavezna da u roku od 30 od dana prijema završnog izveštaja podnese Akcioni Plan u kojem se određuje kako će adresirati preporuke koje su date u izveštaju.		

PK. SH.A. Posta e Kosovës SH.A. Post of Kosovo J.S.C. Pošta Kosova D.D.			
Pranuar: Received: Primijeno: 30-05-2023			
Drejtori: The Director: Direktor:	Numër Number Broj	Shtojca Attached Prilog	Vlera Value Vrednost
	01-	1334/	23



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË POSTËS SË KOSOVËS SH.A PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2023

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Postës së Kosovës sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Postës së Kosovës sh.a (PK sh.a), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2022, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të bashkangjitura ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për pozitën financiare të Postës së Kosovës sh.a deri me 31 dhjetor 2022, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin 2022, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë të përkshuara më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodit të Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera të PK sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë të përshkruara më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodit të Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

- 1 Të hyrat totale të prezantuara në pasqyra financiare të ndërmarrjes për vitin 2022 janë 10,330,503€. Prej tyre 5,160,901€ janë nga klienti kryesor (Telekomi sh.a). Humbja e mundshme e këtij klienti, për të cilin ekzistojnë pasiguri materiale, mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë për të realizuar të hyrat e mjaftueshme dhe të kryejë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit.

Në raportin strategjik të vijimësisë financiare të miratuar nga Bordi i Drejtoreve me datë 13.03.2023, në rast të humbjes së klientit kryesor parashihet që, hapësirat e njëjta të objekteve do të lëshohen me qira institucioneve tjera publike dhe bizneseve private me çmime të tregut. Po ashtu, gjenerimi i të hyrave shtesë parashihet edhe nga lansimi i dy projekteve të reja siç janë Terminali Doganor i Mallrave dhe Post Banka.

Përveç kësaj, ndërmarrja në vitin 2022 ka pranuar një nën huazim nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës me të cilën edhe është nënshkruar marrëveshja e nën-huazimit me likuiditet emergjent për infrastrukturën vitale në vlerë prej 2,147,607€. Sipas menaxhmentit kjo kredi siguron vijimësinë financiare të ndërmarrjes.

Nga viti 2012 ndërmarrja ka treguar humbje të vazhdueshme financiare, ku vlera e humbjeve të akumuluar ka arritur në 23,777,823€, përkatësisht humbja financiare për vitin 2022 ishte 1,410,361€.

Të gjitha pasiguritë materiale të paramenduara më lartë si ishin shpalosur në pasqyra financiare dhe menaxhmenti kishte vlerësuar se nuk ekziston rrezik real që e ndikon parimin e vijimësisë gjatë vitit 2023.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

### **Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to**

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Postës së Kosovës sh.a.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Postës së Kosovës sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Postës së Kosovës sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>2</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Posta e Kosovës, sh.a. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Postës së Kosovës sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Postës së Kosovës sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur që ndërmarrja kishte bërë progres në adresimin e rekomandimeve, duke reflektuar në korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare. Megjithatë, ne kemi vërejtur nevojën për përmirësim të mundshëm të kontrolleve, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet të cilat nuk kanë ndikuar në opinion por vetëm të menaxhimi financiar dhe i pajtueshmërisë janë, pronësia e pa definuar e pronave dhe mbulimi i pozitave me ushtrues detyre.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me dy (2) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim i ri dhe një (1) rekomandim i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

### 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Pasuritë afatgjata

Vlera neto e pasurive afatgjata e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 51,992,387€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me tokën, ndërtesat, pajisjet dhe makineritë, inventari, pajisjet dhe softueri kompjuterik. Për qëllime ekzaminimi, ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 16,167,064€. Përveç kësaj, kemi kryer procedurat analitike substanciale për popullacionin në tërësi sa i përket zhvlerësimit.

#### Çështja B1 - Pronësia e pa definuar e pasurive fikse

##### Gjetja

Korniza Konceptuale në paragrafin 4.12 përcakton që shumë pasuri, për shembull, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë e paluajtshme, shoqërohen me të drejta ligjore, ku përfshihen dhe të drejtat e pronësisë. Në përcaktimin e ekzistencës së një pasurie, e drejta e pronësisë nuk është thelbësore; kështu që, për shembull, një pasuri e paluajtshme me qira është pasuri në qoftë se njësi ekonomike kontrollon përfitimet të cilat priten të vijnë nga kjo pasuri. Megjithatë kapaciteti i një njësie ekonomike për të kontrolluar përfitimet zakonisht është rezultat i të drejtave ligjore, pavarësisht se një zë mund të plotësojë përkufizimin e një pasurie edhe kur nuk ka kontroll ligjor.

Në regjistrat kontabël të pasurive, janë prezantuar gjithsej 174 pasuri të paluajtshme. Mirëpo, sipas dëshmive të ndërmarrjes, pronat me status ligjor të konfirmuar mbi të cilat ndërmarrja ushtron të drejtat pronësore janë gjithsej 25. Për pjesën tjetër të pasurive/pronave statusi ligjor mbi pronësinë është ende i pa definuar. Për adresimin e kësaj çështjeje përveç procedimit të kërkesave në gjykatat përkatëse, përmes Kryesuesit të Bordit ndërmarrja me datë 20.05.2022 kishte dorëzuar në Qeverinë e Kosovës kërkesën për marrjen e vendimit qeveritar lidhur me bartjen e pronësisë së objekteve në emër të ndërmarrjes. Deri në kohën sa ishim në proces të auditimit ndërmarrja nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje nga qeveria. Për adresimin e kësaj çështjeje, shkresa të ngjashme kishte dorëzuar edhe në disa kuvende komunale. Të gjitha informatat lidhur me statusin pronësor të pronave, ndërmarrja i ka shpalosur në PFV-të e vitit 2022.

Sipas drejtorisë ligjore të ndërmarrjes, për kundër veprimeve të ndërmarrja, kontestet pronësore në gjykata janë komplekse të cilat përveç që marrin kohë, në këto procese kundërshtohen paditë e ndërmarrjes për vërtetim pronësie pasi që nuk posedojnë prova të mjaftueshme që do të mund të vërtetohet e drejta pronësore. Kësisoj, zgjidhja e vetme sipas tyre është vendimi qeveritar për bartje të pronësisë së këtyre pronave në emër të ndërmarrjes.

##### Ndikimi

Mungesa e pronësisë me status ligjor të konfirmuar për shumicën e pronave në ndërmarrje, krijon paqartësi pronësore dhe e rrit rrezikun që ndërmarrjes t'i pamundësohet ushtrimi i të drejtave pronësore mbi pronat që potencialisht janë të saj.

##### Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se do vazhdojë të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura/ligjore në mënyrë që të qartësohet statusi i pronave të cilat shfrytëzohen nga Posta e Kosovës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.2 Shpenzimet e pagave

Më 31 dhjetor 2022 shpenzimet e pagave ishin 8,226,922€, ndërsa numri i të punësuarve ishte 931 (në vitin 2021: 938). Për këto shpenzime, kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 51,173€ si dhe dy (2) mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja A1 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre

**Gjetja** Sipas nenit 7 të rregullores së brendshme të ndërmarrjes për marrëdhënie pune Nr.01-2710/21 të datës 09.11.2021, caktimi/sistemimi i punëtorit sipas rasteve të veçanta të paplanifikuara, procedohet me vendim nga kryeshefi ekzekutiv për sistemim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh.

Gjatë testimeve tona për vitin 2022, kemi vërejtur se 36 pozita mbulohen me 47 zyrtar si Ushtrues Detyre (UD) mbi afatin e lejuar ligjor prej gjashtë (6) muaj. Rastet e identifikuar ishin:

- U.D Menaxher/e Regjional/e, shtatë (7) zyrtar;
- U.D Kontrollor/e për letërpostë në PN/QTP, dy (2) zyrtar;
- U.D Koordinator/e i/e Mbikëqyrjes së shërbimeve, dy (2) zyrtar;
- U.D Përgjegjës/e i/e zyrës Postare Komunale, dy (2) zyrtar;
- U.D Zyrtar Regjional i Financave, dy (2) zyrtar;
- U.D Admin. i/e Zhvillimit dhe Përkrahjes së Aplikacioneve, dy (2) zyrtar; dhe
- 30 pozita të tjera janë nga një (1) zyrtar.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, emërimi në pozita Ushtrues Detyre rrjedh nga nevoja e mbulimit të vendeve vakante të punës me personel dhe në pamundësi të zhvillimit procesit të rekrutimit si pasojë e procesit të ristrukturimit të ndërmarrjes.

**Ndikimi** Praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore, përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme në mungesë të konkurrencës së hapur. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e ndërmarrjes në përgjithësi.

**Rekomandimi A1** Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë ndërmarr veprimet për të zhvilluar procedura e rekrutimit, në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja e funksionit si U.D nuk duhet t'i tejkalojë periudhat e përcaktuara ligjore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 kishte rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. NPQ Posta e Kosovës sh.a., kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, tetë (8) rekomandime janë zbatuar; dhe një (1) nuk është zbatuar (shih Grafikonin 1). Ndërsa, në Tabelën 1 është paraqitur një përshkrim më i plotë i rekomandimeve dhe mënyra se si janë trajtuar ato.

Vlen të theksohet se ndërmarrja kishte bërë progres në adresimin e rekomandimeve, duke reflektuar në korrigjimet e duhura në pasqyra financiare.

**Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të përmbajnë informata të detajuara për çështjen e vijimësisë, si dhe në planin e tyre për të ardhmen, të përfshin huazimin e mjeteve, ristrukturimin e borxheve, reduktimin e shpenzimeve apo rritjen e kapitalit.	Të gjitha pasiguritë materiale me të cilat ballafaqohet ndërmarra ishin shpalosur në pasqyra financiare. Po ashtu ishin shpalosur edhe veprimet konkrete të ndërmarra nga menaxhmenti për minimizimin e këtyre pasigurive. Si rezultat menaxhmenti kishte vlerësuar se nuk ekziston rrezik real që e ndikon parimin e vijimësisë gjatë vitit 2023. Kjo çështje është trajtuar tek theksimi i çështjes në këtë raport.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të aplikojë procedura të rregullta të harmonizimit të evidencave kontabël me debitorët ashtu që gjendja e llogarive të arkëtueshme të jetë e pranueshme nga të dy palët, dhe e njëjta gjendje të paraqitet edhe në pasqyra financiare.	Nga 25 letër konfirmime të dërguara tek palët e treta kemi arritur të pranojmë vetëm 5 letër konfirmime me saldo të njëjtë të fundvitit dhe për pjesën tjetër të letër konfirmimeve të papranuar kemi bërë procedura shtesë që kanë rezultuar me ekzistencën e një harmonizimi me partnerët ekonomik.	I zbatuar

3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të formoj një komision dhe të vlerësoj gjendjen funksionale të këtyre pikave, të analizoj nevojën e organizatës për ekzistimin e tyre dhe me një raport të veçantë ta informoj menaxhmentin për gjendjen e tyre të përgjithshme. Më pas, menaxhmenti të merr vendimet e duhura se si të veprohet me to dhe të bëj regjistrimet e duhura në regjistrat e pasurive.	Në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e këtyre pikave shitëse, me datë 29.09.2022 Bordi i drejtorëve kishte marrë vendim për korrjigjimin e kësaj vlere. Si pasuri jo aktive është regjistruar vlera 67,014€, ndërsa vlera prej 267,360€ është korrigjuar me fitim të mbajtur.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, aprovuar dhe publikuar në afatet e paracaktuara ligjore.	Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes me vendimin e datës 14.03.2023 ka aprovuar pasqyrat financiare për vitin 2022.	I zbatuar
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar personat/subjektet juridike, mjetet monetare të të cilëve janë grumbulluar në llogarinë "Sistemi i pagesave" dhe se pagesat e kryera u janë zbritur nga gjendja totale e obligimeve.	Ndërmarrja kishte ndërmarr veprime në vitin 2022 për të identifikuar personat/subjektet juridike, mjetet monetare të të cilëve janë grumbulluar në llogarinë "Sistemi i pagesave".	I zbatuar
6.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve duhet të azhurnoj rregulloren e brendshme në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në mënyrë që të behet prezantimi i duhur i pasurisë dhe shpenzimeve në PFV.	Me datë 07.12.2022 ndërmarrja kishte miratuar udhëzimin për kontabilitet dhe financa bazuar në kërkesat e standardeve përkatëse.	I zbatuar

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

7.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se do vazhdoj të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura/ligjore në mënyrë që të qartësohet statusi i pronave të cilat shfrytëzohen nga Posta e Kosovës.	Kjo çështje akoma nuk është zgjidhur. Sipas menaxhmentit të ndërmarrjes zgjidhja e vetme sipas tyre është vendimi qeveritar për bartje të pronësisë së këtyre pronave në emër të ndërmarrjes. Megjithatë, menaxhmenti pohon se do të vazhdoj përpjekjet që të definohet statusi i pronave.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin kontabël të gjendjes së llogarive të pagueshme dhe furnitorëve të saj në baza periodike, në mënyrë që të konfirmohet vlera saktë e llogarive e pranuar nga dy palët.	Nga 19 letër konfirmime të dërguara tek palët e treta kemi arritur të pranojmë vetëm 8 letër konfirmime me saldo të njëjtë të fundvitit dhe për pjesën tjetër të letër konfirmimeve të papranuar kemi bërë procedura shitesë që kanë rezultuar me ekzistencën e një harmonizimi me partnerët ekonomik.	I zbatuar
9.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se ekzekutimi i pagave bëhet vetëm sipas kontratave të punës dhe çdo ndryshim i vlerës së tyre të reflektojnë në kontrata të reja.	Kjo çështje është zgjidhur pasi që ndërmarrja ka hartuar të gjitha kontrata sipas vlerës së koeficienteve të aprovuara.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit



Krenare Pirana, Anëtare e ekipit




Valbona Pllana, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

### Leter Konfirmimi



PK Sh.A.  
Posta e Kosovës Sh.A.  
Poste of Kosovo / S.E.  
Poste of Kosovo B.E.  
Nr./No./Pr. 01-1292/23  
Data/Date/Emri 26-05-2023  
PRISHTINE-PRISHTINA-PRISHTINA

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Postës së Kosovës sh.a. për vitin 2022 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Fadil Bejtë

Kryesues i Bordit të Postës së Kosovës sh.a

Data: 26. Maj, 2023, Prishtinë,

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- <sup>2</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

POSTA E KOSOVË SH.A.  
Prishtinë, Kosovë  
Prishtinë, Kosovë  
Prishtinë, Kosovë  
Nr. Mbledhjeje: 01-1312/23  
Data/Date/Datum: 29-05-2023  
PRISTINE-PRISTINE-PRISTINA

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
Prishtinë, Kosovë

**Pasqyrat financiare**  
Per vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022

Prishtinë, Mars 2023


## Përmbajtja


PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE .....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET .....	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË .....	6
1. Kompania dhe aktivitetet .....	7
2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare.....	7
3. Përkthimi i valutave të huaja.....	7
4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël .....	8
5. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit .....	13
6. Adoptimi i Standardeve të Reja ose të Rishikuara dhe Interpretimeve .....	13
7. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë ende efektive .....	14
8. Prona, pajisjet dhe impiantet .....	15
9. Pasuritë e paprekshme .....	18
10. Investimi në vijim .....	18
11. Stoqet .....	19
12. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera.....	19
13. Parapagimet.....	20
14. Paraja dhe ekuivalentët e parasë.....	20
15. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera .....	21
16. Të hyrat e shtyra .....	22
17. Të hyrat nga shitjet .....	22
18. KMSH.....	22
19. Shpenzimet operative .....	23
20. Shpenzimet e pagave .....	23
21. Transaksionet me palët e lidhura.....	23
22. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut.....	24
23. Detyrimet kontingjente dhe zotimet .....	26
24. Ngjarjet pas datës së raportimit.....	27


POSTA E KOSOVËS SH.A.  
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR  
Me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

"Posta e Kosoves" SH.P.K.  
Pasqyra e pozitës financiare  
31.12.2022

Shënimi	2022 €	2021 €	
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuria joqarkulluese</b>			
Prona, pajisjet dhe impiantet	8	4,652,540	5,942,278
Pronat dhe ndertesat e rivleresuara		47,084,484	61,435,265
Pasuritë e paprekshme	9	160,131	269,071
Investimet në vijim	10	95,232	355,409
<b>Gjithsej pasuritë joqarkulluese</b>		<b>51,992,387</b>	<b>68,002,023</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Stoqet	11	363,911	283,494
Llogarite e arketueshme dhe te tjera	12	2,120,967	2,392,505
Parapagimet	14	414,931	9,510
Paraja dhe ekuivalentet e parase	13	2,427,815	1,334,931
<b>Gjithsej pasuritë qarkulluese</b>		<b>5,327,625</b>	<b>4,020,440</b>
		<b>57,320,012</b>	<b>72,022,462</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>			
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>			
<b>EKUITETI</b>			
Kapitali aksionar		525,000	525,000
Rezervat e rivleresimit		47,084,484	61,435,265
Fitimet e mbajtura		(23,777,823)	(22,534,762)
Premia e aksioneve		29,600,965	29,600,965
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>53,432,626</b>	<b>69,026,468</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huat afatgjata	15.1	2,147,607	-
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>2,147,607</b>	-
<b>Detyrimet afatshkurta</b>			
Llogarite e pagueshme dhe te tjera	15	1,646,209	2,910,199
Te hyrat e shtyra	16	93,569	85,796
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurta</b>		<b>1,739,778</b>	<b>2,995,995</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>3,887,385</b>	<b>2,995,995</b>
		<b>57,320,012</b>	<b>72,022,462</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>			

  
PK. Posta e Kosovës SH.A.  
Nora Rraçi  
Kryeshefe Ekzekutive

  
PK. Posta e Kosovës SH.A.  
Financat  
PRISHTINË  
PRISHTINË  
J.S.C. - Posta e Kosovës

  
Driton Morina  
ZKFTH

  
Blërim Krasniqi  
Menaxher i Kontabilitetit dhe financave

Shënime: Shqyrtuesit 1-25 në pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

POSTA E KOSOVËS SH.A.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

	Shënimi	2022 €	2021 €
Të hyrat	17	10,330,503	10,516,609
Kostoja e shitjes	18	(328,076)	(387,269)
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>		<b>10,002,427</b>	10,129,340
Shpenzimet operative	19	(1,594,017)	(1,886,116)
Shpenzimet tjera operative			
Shpenzimet e personelit	20	(8,226,922)	(8,492,266)
Shpenzimet e zhvleresimit dhe amortizimit	8	(1,591,850)	(1,680,447)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>		<b>(1,410,361)</b>	<b>(1,929,490)</b>
Shpenzimet financiare			
Të ardhurat financiare-subvencion nga MEPTINIS			
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>(1,410,361)</b>	<b>(1,929,490)</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>		<b>(1,410,361)</b>	<b>(1,929,490)</b>

Shënimet shoqëruese 1-25 në pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

POSTA E KOSOVËS SH.A.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

	Kapitali aksionar €	Premia e aksioneve	Fitimet e mbajtura €	Rezervat e tjera €	Gjithsej €
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>525,000</b>	<b>29,800,565</b>	<b>(19,958,340)</b>		<b>10,367,225</b>
Rregullimet e fitimit të mbajtur			(54,391)		<b>(54,391)</b>
Fitimi / (humbja) i/e vitit			(985,705)		<b>(985,705)</b>
Dividendat					
Dep. e kapitalit shtesë					
Korigjimi i pasurisë		(199,600)			
Ndarja e rezervave				75,786,045	<b>75,786,045</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>525,000</b>	<b>29,600,965</b>	<b>(20,998,436)</b>	<b>75,786,045</b>	<b>84,913,574</b>
Rregullimet e fitimit të mbajtur			393,163		<b>393,163</b>
Fitimi / (humbja) i/e vitit			(1,929,490)		<b>(1,929,490)</b>
Dividendat					
Dep. e kapitalit shtesë					
Korigjimi i pasurisë					
Ndarja e rezervave				(14,350,781)	<b>(14,350,781)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>525,000</b>	<b>29,600,965</b>	<b>(22,534,762)</b>	<b>61,435,265</b>	<b>69,026,467</b>
Rregullimet e fitimit të mbajtur			441,537		<b>441,537</b>
Fitimi / (humbja) i/e vitit			(1,410,361)		<b>(1,410,361)</b>
Dividendat					
Deponimet e kapitalit shtesë					
Korigjimi i pasurisë			(274,236)		<b>(274,236)</b>
Ndarja e rezervave				(14,350,781)	<b>(14,350,781)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>525,000</b>	<b>29,600,965</b>	<b>(23,777,823)</b>	<b>47,084,484</b>	<b>53,432,626</b>

Shenimet shoqëruese 1-25 në pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

	31 dhejtor 2022	31 dhejtor 2021
<b>Aktivitetet operative</b>		
Fitimi para tatimit	<b>(1,410,361)</b>	(1,929,490)
<i>Korrigjuar për:</i>		
Korrigjimet nga vitet e kaluara	441,537	393,163
Provizioni për llogaritë e arkëtueshme		
Zhvierësimi dhe amortizimi	1,591,850	1,680,447
Të ardhurat/ (Shpenzimet) tjera		
<b>Fitimi operativ para ndryshimit në kapitalin qarkullues</b>	<b>623,025</b>	<b>144,120</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues</i>		
Stoqet	(80,417)	(13,516)
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	133,884	671,527
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	(1,256,216)	(1,087,892)
	<b>(1,470,518)</b>	<b>(429,881)</b>
Interesi i paguar		
Tatimi i paguar		
<b>Paraja e gjeneruar (përdorur) në aktivitetet operative</b>	<b>(847,493)</b>	<b>(285,760)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerjet/Heqjet e pasurive joqarkulluese	(207,230)	(138,993)
<b>Paraja e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(207,230)</b>	<b>(138,993)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Dividenda e paguar		
Të ardhurat huamarrja	2,147,607	
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>	<b>2,147,607</b>	
<b>Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>1,092,884</b>	<b>(424,753)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	<b>1,334,931</b>	1,759,685
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>2,427,815</b>	<b>1,334,931</b>

Shenimet shoqëruese 1-25 në pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrove financiare.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

**1. Kompania dhe aktivitetet**

"Posta e Kosovës" sh.a. ("Shoqëria") është kompani aksionare e themeluar (inkorporuar) më 21 Dhjetor 2011 me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 16/53. Për ndarjen e njësisë biznesore "Posta e Kosovës" nga "Posta dhe Telekomunikimet e Kosovës" Sh.a (PTK) në entitet të veçantë. Regjistrimi i Kompanisë së re për Shërbimet Postare pranë Ministrisë për Tregti dhe Industri - Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë me numër regjistrimi të biznesit 70847701 është bërë më datë 7 maj 2012 me emrin "Posta e Kosovës" Sh.a. me pronarë Qeveria e Republikës së Kosovës. Kapitali i përgjithshëm i regjistruar, bazuar në certifikatën e regjistrimit të biznesit pranë Agjensionit të Regjistrimit të bizneseve kap shumën e 525 mijë euro dhe primit aksionar prej 30,000,000.00 euro. "Posta e Kosovës" Sh. a posedon nr. fiscal 600815924. Adresa e regjistruar dhe vendi kryesor i biznesit, "Posta e Kosovës" Sh.a është : Dardania - Prishtinë. Pronare kryesore e kompanisë është Qeveria e Kosovës.

*Aktivitetet kryesore të Kompanisë*

6411 - Ofrimi i shërbimit publik postar  
6511- Ndërmjetësime tjera monetare,  
7220- Këshillime dhe sigurimi i pajisjeve programore (softuerit),  
7260- Veprimtaritë tjera të lidhura me makinat llogaritëse (informatike),  
7420- Veprimtaria e arkitekturës dhe inxhinierisë dhe keshilla lidhur me to,  
7484- Veprimtari tjera afariste p.c.  
7511- Veprimtaritë e shërbimeve të përgjithshme publike,  
9305- Veprimtari tjera shërbyese p.c.  
6713- Veprimtari ndihmëse të shërbimit financiar,p.c.  
6523- Ndërmjetësime tjera financiare, p.c..

Më 31 dhjetor 2022, Kompania ka pasur gjithsej 929 të punësuar (2021: 944 të punësuar).

**2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNRF) sipas konventës së kostos historike.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël të caktuara kritike. Gjithashtu, kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të shpalosura në Shënimin 5.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur thuhet ndryshe (shih Shënimin 6 & 7 për standardet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Kompania).

**3. Përkthimi i valutave të huaja**

Monedha funksionale e Kompanisë është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon entiteti. Monedha funksionale e Kompanisë dhe monedha e prezantimit është Euro ("EUR"), e cila është monedha ligjore në Republikën e Kosovës.

Në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), EUR është miratuar si monedhë e vetme ligjore në territorin e Kosovës nga 1 janari 2002.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

**4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

***Prona, impiantet dhe pajisjet***

Prona dhe pajisjet janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe minus humbjet nga dëmtimi i aseteti, nëse ka. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së artikujve. Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të asetëve ose njihen si një aset i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Kur pjesët e një artikulli të pronës dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të dobishme, ato llogariten si zëra të veçantë (përbërës kryesorë) të pronës dhe pajisjeve.

**Humbja nga dëmtimi i asetëve:** Në fund të çdo date të raportimit, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues për dëmtim të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, menaxhmenti vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aseti me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi (dëmtimi) njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi (dëmtimi) e njohur për një aset në vitet paraprake rikthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e asetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

**Zhvlerësimi:** Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i zërave të tjerë të pronës, impianteve dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar:

**Jetë të dobishme në vite**

Ndërtesat	20 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite
Automjete	5 vite
Pasuri tjera të trupëzuara	5 vite

Vlera e mbetur e një aseti është vlera e parashikuar që Kompania aktualisht do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit e asetit minus kostot e vlerësuar të nxjerrjes jashtë përdorimit, nëse aseti ishte tashmë në moshë dhe në gjendje që pritet të jetë në fund të jetës së saj të dobishme. Vlerat e mbetura të asetëve dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe korrigjohen nëse është e përshtatshme, në fund të çdo periudhe raportuese.

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël neto dhe njihen neto brenda të ardhurave/shpenzimeve tjera operative në fitim ose humbje.

**Instrumentet financiare**

***Njohja dhe çregjistrimi***

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar. Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat e kontratës për rrjedhat e parave nga pasuria financiare skadojnë, ose kur pasuria financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

***Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare***

Me përjashtim të atyre të arkëtueshmeve tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi dhe që maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të korrigjuar për kostot e transaksionit (kur është e aplikueshme).

Pasuritë financiare, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kosto e amortizuar
- vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura, kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si FVOCI.

***Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare (vazhdim)***

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

Klasifikimi përcaktohet nga të dy:

- modeli i biznesit të entitetit për menaxhimin e pasurisë financiare
- karakteristikat kontraktuale të rrjedhës së parave të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me pasurinë financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda kostove të financimit, të ardhurave nga financimi ose zërave të tjerë financiarë, përveç dëmtimit të llogarive të arkëtueshme tregtare, i cili paraqitet brenda shpenzimeve të tjera.

*Matja pasuese e pasurive financiare*

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk përcaktohen si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë financiare dhe të mbledhë rrejdhat kontraktuale të parasë
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare shkaktojnë rrjedha të parasë që janë vetëm pagesa të principalit dhe kamatës mbi shumën kryesore të mbetur

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Skontimi shmanget kur efekti i skontimit është jomaterial. Paraja dhe ekuivalentët e parave të kompanisë, llogaritë e arkëtueshme dhe shumica e të arkëtueshmeve tjera hyjnë në këtë kategori instrumentesh financiare, si dhe obligacione të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim nën SNK 39.

*Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)*

Pasuritë financiare që mbahen brenda një modeli biznesi të ndryshëm përveç "mbajtjes për të mbledhur" ose "mbajtjes për të mbledhur dhe shitur", kategorizohen në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Për më tepër, pavarësisht nga pasuritë financiare të modelit të biznesit, rrjedhat e parasë kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative hyjnë në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilat aplikohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

*Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)*

Kompania trajton pasuritë financiare në FVOCI nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen nën një model biznesi, objektivi i të cilit është "mbajë për të mbledhur" dhe shes rrjedhat përkatëse të parave
- Kushtet kontraktuale të pasurive financiare shkaktojnë rrjedha të parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të mbetur.

Çfardo fitimi ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çregjstrimit të aktivit.

*Dëmtimi i pasurive financiare*

Kërkesat e SNRF 9 për zhvlerësimin të përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritura të kredisë - modeli "i humbjes së pritshme të kredisë (ECL)". Kjo zëvendësoi "modelin e humbjes së shkaktuar" të SNK 39. Instrumentet brenda objektivit të kërkesave të reja përfshijnë kredi dhe aktive të tjera financiare të llojit të borxhit të matur me kosto të amortizuar dhe FVOCI, arkëtime tregtare, asete kontrate të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe angazhimet e kredisë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) që janë nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kredisë nuk varet më nga kompania që së pari të identifikoj një ngjarje të humbjes së kredisë. Përkundrazi, kompania merr në konsideratë një gamë më të gjerë informacioni kur vlerëson rrezikun e kredisë dhe matë humbjet e pritura të kredisë, përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në mbledhjen e pritshme të rrjedhave të ardhshme të parave të instrumentit.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

**Dëmtimi i pasurive financiare (vazhdim)**

Në zbatimin e kësaj qasje që shikon përpara, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiarë që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët kredie ('Faza 1') dhe
- instrumente financiarë që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

"Faza 3" do të mbulojë pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të dëmtimit në datën e raportimit.

"12-mujt e pritshme të humbjes së kredisë", njihen për kategorinë e parë, ndërsa "humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës" njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritura të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar i mundshëm i humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

**Të arkëtueshmet dhe pasuritë e kontraktuara**

Kompania përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilitetin e të arkëtueshmeve, si dhe pasuritë kontratës dhe regjistron lejimin e humbjes si humbje të pritshme të kredisë. Këto janë mangësitë e pritura në rrjedhat kontraktuale të parasë, duke marrë parasysh potencialin e mospagimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Në llogaritjen, kompania përdor përvojën e tij historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhshëm për të llogaritur humbjet e pritura të kredisë duke përdorur një matricë provizioni.

**Dividendët.** Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, janë të shpalosura në shënime të ngjarjeve të mëvonshme. Raportet statutorë të kontabilitetit të Kompanisë janë baza për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjeve të tjera. Legjislacioni i Kosovës identifikon bazën e shpërndarjes si fitim neto i vitit aktual.

**Provizionet për detyrimet dhe detyrimet.** Provizionet për detyrimet dhe detyrimet janë detyrime jofinanciare me kohë ose shuma të pasigurta. Ato janë përlogaritur kur Kompania ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit mund të të bëhet. Rezervat maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohet për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasare dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provizion për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim i interesit.

**Të hyrat nga kontratat me konsumatorët.** Të hyrat maten bazuar në konsideratën e specifikuar në kontratën me konsumatorin dhe përjashton shumat e mbledhura në emër të palëve të treta. Kompania njihet të hyrat kur e transferon kontrollin mbi produktin ose shërbimin te konsumatori. Të hyrat janë kryesisht nga ofrimi i shërbimit publik postar

Në përcaktimin nëse të njihet një e hyrë, Kompania ndjek procesin 5-hapësh:

1. Identifikimi i kontratës me konsumatorin
2. Identifikimi i obligimit të performancës
3. Përcaktimi i çmimit të transaksionit
4. Alokimi i çmimit të transaksionit në obligimet e performancës
5. Njohja e të hyrave kur përmbushet obligimi i performancës.

Të hyrat njihen ose në një pikë në kohë ose përgjithësisht, kur kompania përmbushë obligimet e performancës duke transferruar mallrat ose shërbimet e premtuara te konsumatorët.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

*Shitja e mallrave*

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen në një moment në kohë kur konsumatori përfton kontrollin mbi mallrat, që në përgjithësi është në kohën e dërgesës së tyre.

*Ofrimi i shërbimeve*

Të hyrat nga një kontratë oëer ofrimin e shërbimeve njihen përgjatë kohës kur kryhet shërbimi bazuar ose në çmim fiks ose normë ore.

*Të hyrat tjera*

Të hyrat tjera njihen kur pranohen ose kur është përcaktuar e drejta për të pranuar pagesën.

**Përfitimet e punonjësve**

**Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore:** Shoqëria kontribuon vetëm në planin e pensioneve të administruara publikisht, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (KPST), siç kërkohet me ligj. Kompania nuk ka detyrime të mëtejshme të pagesës pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve kur ato janë për shkak. Kompania nuk ka detyrime të mëtejshme ndaj punonjësve të saj përtej këtyre kontributeve.

**Përfitimet e daljes në pension:** Kompania nuk siguron dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi dhe mbi kontributet e përshkruara në këtë shënim

**Tatimi mbi të ardhurat**

Tatimi mbi të ardhurat aktuale llogaritet në bazë të rregullave të tatimit mbi të ardhurat të aplikueshme në Kosovë, duke përdorur normat e tatimit të miratuara në datën e raportimit. Në fuqi nga 1 janari 2010 norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është 10% në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës që aktualisht janë në fuqi, Ligji nr. 06 / L-105 "Per Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

Tarifa e tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përbëhet nga tatimi aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm të pritur për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje sepse ajo përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të tjera dhe përveç kësaj përjashton zërat që nuk janë kurrë të tatueshëm ose të zbritshëm. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave llogaritet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit për të gjitha diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar.

Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivitetet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, transferimin e aktiveve tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të papërdorura, deri në masën që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme, dhe humbjet e papërdorura tatimore mund të përdoren. Vlera kontabël e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar shfrytëzimin e të gjithë ose një pjese të aktivitetit të tatimit të shtyrë.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat tatimore që pritet të zbatohen në periudhën kur aktiviteti është realizuar ose detyrimi është shlyer, në bazë të normave tatimore (dhe ligjeve tatimore) të cilat janë miratuar ose janë substanciale në datën e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra janë kompensuar kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ekziston synimi për të shlyer gjendjet në bazë neto.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
*Të gjitha shumat në Euro*

**Tatimi mbi të ardhurat (vazhdim)**

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Kompania merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse mund të jenë të detyrueshme tatimet dhe interesat shtesë. Kompania beson se akcizat e saj për detyrimet tatimore janë adekuate për të gjitha vitet e hapura tatimore bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktoreve, duke përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh mbi ngjarjet e ardhshme. Informacioni i ri mund të bëhet i disponueshëm që shkakton që kompania të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshimet e tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën kur një përcaktim i tillë është bërë.

**Tatimi mbi vlerën e shtuar ("TVSH")**

Tatimi mbi vlerën e shtuar të produktit që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore me herët (a) mbledhjen e të arkëtueshmeve nga konsumatorët ose (b) dërgimin e mallrave ose shërbimeve ndaj klientëve. TVSH-ja e inputeve në përgjithësi mund të rikthehet kundrejt TVSH-së së outputeve pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja e lidhur me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe shpallet veçmas si një aktiv dhe pasiv. Kur janë bërë provizionet për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

**5. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit**

Kompania bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhmentit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat. Menaxhmenti gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

**Jetëgjatesia e aktiveve:** Përcaktimi i jetëgjatësisë së aktiveve aseteve bazohet në përvojën historike me aktive të ngjashme, si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshime në faktorët e gjerë ekonomikë ose të industrisë. Përshtatshmëria e jetëgjatësisë së vlerësuar rishikohet çdo vit, ose sa herë që ka një tregues të ndryshimeve të rëndësishme në supozimet themelore. Për më tepër, për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve të amortizueshme në aktivet tona totale, ndikimi i ndonjë ndryshimi në këto supozime mund të jetë material për pozitën tonë financiare dhe rezultatet e operacioneve.

**Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve tjera:** Kompania llogarit zhvlerësimin për llogarite e dyshimta bazuar në humbjet e vlerësuar si pasojë e pamundësisë së klientëve tanë për të bërë pagesat e kërkuara. Sipas politikave të kompanisë, faktorët e mëposhtëm merren në konsideratë gjatë vlerësimit të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve: pagesa të shpeshta me vonesë, klientë me rrezik të lartë dhe klientë me vështirësi financiare, me përjashtim të tregtarëve me shumicë dhe partnerëve të lidhur. Këta faktorë rishikohen në mënyrë periodike dhe bëhen ndryshime në llogaritjet kur është e nevojshme. Vlerësimet përfshijnë supozimet në lidhje me sjelljen e konsumatorëve të ardhshëm dhe mbledhjet e ardhshme të parasë në të ardhmen. Nëse gjendja financiare e klientëve tanë do të përkeqësohej, zhvlerësimi aktual i arkëtueshmeve ekzistuese mund të jetë më i lartë se sa pritej dhe mund të tejkalojë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri më tani.

**6. Adoptimi i Standardeve të Reja ose të Rishikuara dhe Interpretimeve**

**Adoptimi i SNRF 16 "Lizingu" dhe doption of IFRS 16 "Leases" and IFRIC 4 Përcaktimi nëse një kontratë përmban lizing.** Kompania ka adoptuar SNRF 16 dhe IFRIC 4 nga 1 janar 2019. SNRF 16 ofron modelin kontabël për lizingmarrësin, duke kërkuar njohjen e pasurive dhe detyrimeve për të gjitha lizingjet, së bashku me opcionin për të përjashtuar lizingjet me afat të barabart ose më të shkurt se 12 muaj, ose kur pasuria nën lizing është me vlerë të

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

ulët. SNRF 16 në mënyrë substanciale është e ngjashme me SNK 17 sa i përket lizindhënësit, duke mbajtur dallimin në mes të lizingut operativ dhe financiar. Kompania nuk ka aktivitete domethënëse si lizingdhënës.

*Metoda e tranzicionit dhe mënyra praktike e përdorur*

Kompania ka zgjedhur të zbatoj mënyrën praktike për të mos rivlerësuar nëse një kontratë është, ose përmban lizing në datën e zbatimit të standardit. Kontratat para datës së tranzicionit të cilat nuk ishin identifikuar si lizingje sipas SNK 17 dhe IFRIC 4, nuk janë rivlerësuar. Definicioni i lizingut sipas SNRF 16 është zbatuar vetëm për kontratat që kanë hyrë në fuqi me ose pas 1 janar 2019.

Kompania ka zbatuar disa mënyra praktike të lejuara sipas SNRF 16 për lizingjet që më herët janë klasifikuar si lizingje operative sipas SNK 17:

- (a) Zbatimi i një norme të vetme të skontimit për portfoliot e lizingjeve që në mënyrë të arsyeshme kanë karakteristika të ngjashme;
- (b) Përfashtimi i kostove direkte nga matja e pasurisë me të drejtë përdorimit në datën e zbatimit fillestar për lizingjet ku pasuria me të drejtë përdorimi është përcaktuar sikur SNRF 16 është zbatuar që nga data e fillimit;
- (c) Mbështetja mbi vlerësimet e mëparshme nëse lizingjet janë të vështira kundrejt përgatitjes së një rishikimi për dëmtim sipas SNK 36 në datën e zbatimit fillestar; dhe
- (d) Zbatimi i përfashtimit për të mos njohur pasuritë dhe detyrimet me të drejtë përdorimi për lizingjet me afat të mbetur më të shkurt se 12 muaj në datën e zbatimit fillestar.

Si lizingmarrës, kompania më herët ka klasifikuar lizingjet si operativ ose financiar bazuar në vlerësimin nëse lizingu ka transferuar në mënyrë domethënëse rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Sipas SNRF 16, Kompania njeh pasuritë dhe detyrimet me të drejtë përdorimi për shumicën e lizingjeve. Mirëpo kompania ka zgjedhur të mos njoh pasuritë dhe detyrimet me të drejtë përdorimi për disa lizingje për pasuri me vlerë të ulët bazuar në vlerën e pasurisë përkatëse të re ose për lizingjet afatshkurta me afat të kontratës prej 12 muaj ose më pak.

**7. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë ende efektive**

Ka disa standarde, ndryshime të standardeve të cilat janë publikuar nga IASB që janë efektive për periudhat kontabël ne të ardhmen, të cilat kompania ka vendosur të mos i adoptojë më herët.

Më domethënëset janë siç vijon, të gjitha prej të cilave janë efektive për periudhën që fillon me 1 janar 2020:

- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe gabimet (Amandamenti – Definimi i Materialitetit)
- SNRF 3 Kombinimet e Bizneseve (Amandamenti – Definimi i Biznesit)
- Korniza Konceptuale për Raportim Financiar e Rishikuar

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

**8. Prona, pajisjet dhe impiantet**

	<b>Toka</b>	<b>Ndërtesa</b>	<b>Pajimet &amp; Makinat</b>	<b>Total</b>
<b>Kosto:</b>				
<b>Me 31 dhjetor 2018</b>	<b>196,800</b>	<b>26,576,925</b>	<b>5,653,816</b>	<b>32,427,541</b>
Shtesat/Heqjet			(212,511)	(212,511)
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>196,800</b>	<b>26,576,925</b>	<b>5,441,305</b>	<b>32,215,031</b>
Shtesat/Heqjet		(240,050)		(240,050)
Rivlerësim i asetve	10,331,700	65,454,345		75,786,045
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>10,528,500</b>	<b>91,791,220</b>	<b>5,441,305</b>	<b>107,761,026</b>
Shtesat		5,003	19,378	24,381
Heqjet			(360,105)	(360,105)
Rivlerësim i asetve				
<b>Me 31 dhjetor 2021</b>	<b>10,528,500</b>	<b>91,796,223</b>	<b>5,100,578</b>	<b>107,425,302</b>
Shtesat		78,782	17,257	96,039
Heqjet		(6,875)	(32,142)	(39,017)
Rivlerësim i asetve				
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>10,528,500</b>	<b>91,868,130</b>	<b>5,085,693</b>	<b>107,482,323</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar:</b>				
<b>Me 31 dhjetor 2018</b>	<b>0.00</b>	<b>(16,968,419)</b>	<b>(4,984,085)</b>	<b>(21,952,504)</b>
Zhvlerësimi i vitit		(1,281,026)	(211,567)	(1,492,593)
Rregullimi në Zh.A.			240,431	240,431
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>(18,249,445)</b>	<b>(4,955,220)</b>	<b>(23,204,665)</b>
Zhvlerësimi i vitit		(1,149,880)	(168,935)	(1,318,815)
Rregullimi në Zh.A.		(116,650)		(116,650)
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b></b>	<b>(19,515,975)</b>	<b>(5,124,155)</b>	<b>(24,640,130)</b>
Zhvlerësimi i vitit		(1,253,928)	(163,025)	(1,416,953)
Rregullimi në Zh.A.		(14,350,781)	360,105	(13,990,676)
<b>Me 31 dhjetor 2021</b>	<b></b>	<b>(35,120,684)</b>	<b>(4,927,075)</b>	<b>(40,047,759)</b>
Zhvlerësimi i vitit		(1,254,541)	(124,360)	(1,378,902)
Rregullimi në Zh.A.			32,142	32,142
Rregullimi në Zh.A.		(14,350,781)		(14,350,781)
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b></b>	<b>(50,726,006)</b>	<b>(5,019,293)</b>	<b>(55,745,299)</b>
<b>Vlera neto në libra:</b>				
<b>Me 31 dhjetor 2018</b>	<b>196,800</b>	<b>9,608,506</b>	<b>669,732</b>	<b>10,475,038</b>
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>196,800</b>	<b>8,327,480</b>	<b>486,085</b>	<b>9,010,365</b>
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>10,528,500</b>	<b>72,275,246</b>	<b>317,150</b>	<b>83,120,895</b>
<b>Me 31 dhjetor 2021</b>	<b>10,528,500</b>	<b>56,675,540</b>	<b>173,503</b>	<b>67,377,543</b>
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>10,528,500</b>	<b>41,142,124</b>	<b>66,400</b>	<b>51,737,024</b>

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
*Të gjitha shumat në Euro*

Aktivitet afatgjatë materiale (toka, ndërtesa) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri është mbart me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit. Posta e Kosovës ka angazhuar kompanin e licencuar për rivlerësim dhe bazuar në raportin e kësaj kompanie data e hyrjes në fuqi e rivlerësimit është data 31.12.2020. Baza e regjistrimit të asetëve pas ri-vlerësimit është bërë sipas SNK 16 paragrafi 31 (metoda e ri-vlerësimit). Jetegjatesia e asetëve si baza për zhvlerësim nuk ka ndryshuar në raport me jetegjatesinë e asetëve para vlerësimit. Me raportin e vlerësimit është përcaktuar vetëm vlera e drejtë e asetëve.

Rivlerësimi i pronave të paluajtshme Posta e Kosovës Sh.A. është realizuar po ashtu në përputhje me Standarde Evropiane të Vlerësimit (EVS 2016). Vlera e tregut është sasia e vlerësuar për të cilën një pasuri do të shkëmbehet në datën e vlerësimit, në mes të blerësit dhe shitësit të vullnetshëm, në një transaksion të duhur ku secila palë ka vepruar me koshiençë, kujdes dhe pa detyrim.

Vlera prej 28,701,562-euro paraqet zhvlerësimin e akumuluar për pjesën e rivlerësimit të pronave/ndertesave gjithnjë duke u bazuar në SNK 16 – Për rivlerësimin e pronave si dhe bazuar në SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve.

Sipas vendimit të BtD 01-2138/22 shtesat në vlerë prej 78,782.- euro janë si rezultat e aktivizimit të Butik pikave që ishin investime në vijim në vlerë prej 334,374.- euro dhe në vitin 2022 pas një vlerësimi nga komisioni vlera e butik pikave për aktivizim të mjetetit themelore ishte 67,014.- euro dhe pjesa tjetër prej 267,360.- euro është mbyllur me humbje kapitale. Pjesa tjetër e shtesave ka të bëjë me blerjet kapitale gjatë vitit në vlerë prej 8,968.- euro dhe pjesa prej 2,799.- euro rrjedh nga aktivizimi Renovim i objektit Z.P. Peje.

Heqjet nga ndertesat janë bërë sipas vendimit të BtD 01-3088/22 në vlerë prej 6,875 euro.

Vlera e shtesave të pajisjet & makina përfshinë donacionet nga ministrat në vlerë prej 9,000-euro si dhe blerjet kapitale në vlerë prej 8,257 euro.

Heqjet të pajisjet në vlerë prej 32,142-euro janë bërë bazuar në vendimin e KE me nr.01-2903/22.

Ashtu siç kemi deklaruar edhe viteve të kaluara, kontestet gjyqësore në Gjykata janë komplekse dhe si të tilla nuk mund të zgjidhen në një periudhë të shkurtër kohore, duke pasur parasysh faktin se për shkak të pandemisë gjykatat kanë pasur ndërprerje të kohëpaskohshme, por edhe procedurat nëpër gjykata marrin kohë.

Po ashtu, në procese gjyqësore kundërshtohen paditë e Postës së Kosovës, për vërtetim të pronësisë pasi që statusi i pronave në shumicën e rasteve janë të evidentuara si prone shoqërore, në emër të komunave, ndërkaq në si PK, nuk po kemi prova të mjaftueshme që do të mund të vërtetohet e drejta e jonë mbi parcelat në të cilat janë të ndërtuara objektet e PK, pasi që i përkasin periudhave të viteve 70-ta dhe 80-ta në të cilat prona shoqërore dhe ndërtimet e objekteve publike shtetërore janë konsideruar si të barabarta.

Për këtë arsye dhe me qëllim të shmangies së procedurave gjyqësore, të cilat nuk garantojnë sukses në këtë drejtim, sepse mungojnë provat materiale (Baza ligjore), në si PK kemi marrë veprime duke ndjekur praktikën e ndërmarrjeve tjera dhe kemi adresuar Kërkesën për prurjen e vendimit qeveritar lidhur me bartjen e pronësisë së objekteve dhe pronave në emër të Ndërmarrjes Publike Qendrore – Posta e Kosovës. Kërkesa është me nr.01-672/22 dhe date 01.04.2022.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
*Të gjitha shumat në Euro*

Në anën tjetër janë bere përditësimet si ne vijim:

**1.Pronat te cilat nuk ekzistojnë**

Sipas kësaj pike pronat e evidentuara, nuk mund te barten ne pronësi sepse te njëjta nuk kane qene asnjëherë ne pronësi te Telekomit ( PTK), por vetëm si shfrytëzues i hapësirë- parcelës dhe kane patur statusin e objektit montazh- te përkohshëm.

**2.Pronat me titullar Posta e Kosoves**

Ky proces është i përfunduar dhe këto prona figurojnë si prona te Postes se Kosoves.

**3. Pronat me titullar Prone Shoqërorë-Komunale**

Kjo kategori e pronave qe titullar i pronësisë janë Komuna, Ndërmarrjet Shoqërore apo prone e Kooperativës. Për këtë kategori dhamë sqarimet e mësipërme dhe kërkesa ne qeveri i referohet këtyre pronave.

**4. Pronat e uzurpuara ne Enklavat serbe**

Kjo kategori e pronave te cilat gjenden ne enklavat serbe janë ç’regjistruara në sistemin e kontabilitetit dhe mbahen ne shenime shpjeguese.

**5. Apartamentet – banesat ne pronësi te Ndërmarrja -publike banesore**

Apartamentet gjenden ne pronësi te Ndërmarrjes Publike Banesore. Sipas informatave nga Ndërmarrja publike banesore këto apartamente gjenden ne procedura gjyqësore te iniciuara nga ndërmarrja banesore, me qellim te lirimit nga njerëzit dhe sendet, dhe edhe tutje gjenden ne procedura gjyqësore. Te njëjtat janë çregjistruara në sistemin e kontabilitetit dhe mbahen ne shenime shpjeguese.

Pas shqyrtimeve te këtyre evidencave, PK do te vazhdojmë mbi bazat ligjore te fitimit te pronësisë.

Konsiderojmë se vendimi qeveritar për te cilin kemi adresuar Kërkesën për bartjen e pronave, do te jete një lehtësim dhe mundësia e mire, me ç’rast me prurjen e këtij vendimi qeveritar kjo do te jete një baze e vetme për regjistrimet para organeve komunale kadastrale.

Gjithashtu gjatë vitit 2022, Zyrat Komunale Kadastrale të Lipjanit, Vushtrris dhe Podujeves, kan berë rregullimin e statusit pronësor të tokave ku janë objektët e PK sh.a, duke berë regjistrimin e tokave ne regjistrat kadastrale në emër të Postes së Kosovës sh.a.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

**9. Pasuritë e paprekshme**

	Software dhe Sistemi Faturimit	Total
<i>Kosto:</i>		
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,547,855</b>	<b>1,547,855</b>
Shtesat/Heqjet	114,933	114,933
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,662,788</b>	<b>1,662,788</b>
Shtesat/Heqjet	96,721	96,721
<b>Me 31 dhjetor 2021</b>	<b>1,759,509</b>	<b>1,759,509</b>
Shtesat/Heqjet	104,008	104,008
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>1,863,517</b>	<b>1,863,517</b>
<i>Zhvlrësimi i akumuluar:</i>		
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>(965,537)</b>	<b>(965,537)</b>
Zhvlrësimi i vitit	(264,606)	(264,606)
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>(1,230,143)</b>	<b>(1,230,143)</b>
Zhvlrësimi i vitit	(260,295)	(260,295)
<b>Me 31 dhjetor 2020/2021</b>	<b>(1,490,438)</b>	<b>(1,490,438)</b>
Zhvlrësimi i vitit	(212,948)	(212,948)
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>(1,703,386)</b>	<b>(1,703,386)</b>
<i>Vlera neto në libra:</i>		
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>582,318</b>	<b>582,318</b>
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>432,645</b>	<b>432,645</b>
<b>Me 31 dhjetor 2021</b>	<b>269,071</b>	<b>269,071</b>
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>160,131</b>	<b>160,131</b>

Te pasuritë e paprekshme është zbatuar SNK 38 dhe sipas pikes 97 respektivisht 98, kompania ka zgjedh metodën lineare që pasqyron më mirë tiparin e pritshëm të konsumit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktiv. Kjo metodë zbatohet në mënyrë të qëndrueshme nga periudha në periudhë përveç se kur ka një ndryshim në tiparin e pritshëm të konsumit të këtyre përfitimeve ekonomike të ardhshme.

Gjatë vitit 2022 ka pasur shtesa në vlerë prej 104,008-euro nga regjistrimi i licencave të Microsoftit pjesa e tretë e faturës nga InfoSoft.

**10. Avanset për investime & Investimi në vijim**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Avanset për investime	18,235	18,235
<b>Total Avanset për investime</b>	<b>18,235</b>	<b>18,235</b>
<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Investimet në vijim	76,996	337,174
<b>Total</b>	<b>76,996</b>	<b>337,174</b>

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

<b>Total Avanset dhe investimet ne vijim</b>	<b>95,232</b>	<b>355,409</b>
--	---------------	----------------

Avanset për investime paraqesin vlerën e dhënë avans për investimet kapitale të cilat janë në proces. Avanset ne vitin 2022 janë po të njëjtat ndersa Investimet ne vijim janë zvogluar sipas vendimit 01-2138/22 të BtD ku Butik pikat ishin investime në vijim në vlerë prej 334,374.79.

**11. Staqet**

<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Pulla Postare	104,794	93,272
Formularët me Vlerë	26,768	21,715
Stoku elektronik (US\$D)	43,906	49,004
Stoku të Posta Hibrde	148,823	60,801
<b>Total stoqet PK</b>	<b>323,752</b>	<b>224,791</b>

**Materialet tjera ne depo per nevoja vetanake**

Mjetet e Punës	6,712	5,771
Material Hargjues	21,940	46,971
Veshëmbathja	1,202	2,710
Teknologjia Informative	10,305	3,250
<b>Materiale dhe inventar i imët</b>	<b>40,159</b>	<b>58,702</b>

<b>Total</b>	<b>363,911</b>	<b>283,494</b>
--------------	----------------	----------------

Stoqet Kompania i ka trajtuar sipas SNK 2, stokun e mban sipas koston, pra Kosto përfshin të gjitha koston e blerjes, koston e transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura për sjelljen e inventareve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale

I kemi paraqit ne dy grupe mallrat qe janë ne depot e PK dhe atë ne mallra për shitje dhe materiale të tjera për nevoja vetanake të PK.

**12. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera**

<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Posta vendore	346,509	334,696
Posta ndërkombëtare	682,343	351,883
Blerësit vendorë	178,077	228,815
Kërkesa- sistemi I pagesave	33,590	70,456
Shërbime të qirasë dhe të tjera	851,386	1,263,519
Shërbime të postës dhe të tjera	763	571
Kërkesa akruale	67,898	170,487
<b>Total</b>	<b>2,160,566</b>	<b>2,420,428</b>

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

<b>Provizionimet</b>			
Provizionet - borxhe të kqija		(62,078)	(49,485)
Provizionet tjera (Plaçkitjet, Mungesat)		(3,416)	(3,416)
<b>Total</b>	-	<b>65,494</b>	- <b>52,901</b>

Llogarite e arketueshme	2,095,072	2,367,527
Kërkesa të tjera	25,895	24,977
<b>Total</b>	<b>2,120,967</b>	<b>2,392,505</b>

Gajte vitit 2022 janë bërë korigjimet në vlerën e llogarive të arketueshme pasi që ato njihen vetëm kur plotësohen kushtet për njëjtit sipas standardeve të kontabilitetit.

\*Provizionet tjera paraqesin plaçkitjet dhe mungesat në mjete monetare për të cilat kompania i ka trajtuar sipas "SNK 37 Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente"

Menaxhmenti ka caktuar një datë specifike dhe uniforme të prerjes për korigjimet pas datës së raportimit për të gjithë furnitorët/klientët e postës ndërkombëtare dhe rrjedhimisht, kërkesat e SNK 10 janë aplikuar në mënyrë adekuate.

Të gjitha harmonizimet e bilanceve me Postat ndërkombëtare janë përfshirë brenda periudhës të caktuar dhe të njëjtat janë paraqit me koston neto të tyre (kërkesat & detyrimet).

### 13. Parapagimet

<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Parapagime për tatime dhe të tjera	406,396	2,451
Parapagime për sigurime	8,535	7,059
<b>Total</b>	<b>414,931</b>	<b>9,510</b>

Parapagimet për tatime dhe të tjera janë tatimet e paguara në ATK nga qiramarrësit si tatim në burim për qira e që i takojnë një pjesë e vitit 2021 por të paguara në vitin 2022 (92,151 euro) dhe pjesa tjera e vitit 2022 (bazuar në certifikata) që janë paguar në vitin 2022 në vlerë prej 314,246 euro. Ky ndryshim i parapagimeve për tatime krahasuar me vitin paraprak është si rrjedhojë e ndryshimeve të trajtimit të tatimit në burim për qira

Parapagimet për sigurime janë për sigurimet njëvjeqare të automjeteve.

### 14. Paraja dhe ekuivalentët e parësë

<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
----------------------	-------------	-------------

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

**Që I takon Kompanisë**

Paraja në arkë	7,348	3,461
Paraja në bankë	1,341,146	42,337
Depozita afatshkurtëra		0
<b>Nën-Total (I)</b>	<b>1,348,494</b>	<b>45,798</b>
<b>Që u takon klientëve</b>		
Paraja në arkë	956,371	1,022,459
Paraja në bankë	122,951	266,674
<b>Nën-Total (II)</b>	<b>1,079,322</b>	<b>1,289,133</b>
<b>Total (I+II)</b>	<b>2,427,816</b>	<b>1,334,931</b>

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 kompania kishte në Arkë dhe në Bankë para që u takojnë klientëve për

<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Furnitore vendor dhe jovendor	353,646	932,080
Obligimet tatimore	143,235	197,415
Obligimet për paga	15,711	380,049
Llogaritë e pagueshme	1,133,617	1,400,655
<b>Total</b>	<b>1,646,209</b>	<b>2,910,199</b>

shërbimet financiare si lute Credit, Skema Sociale, Western Union, Kompanitë publike, SHFJB etj. në vlerë prej 1.079,322 Euro (2021: 1,289,133 Euro).

**15. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera**

**15.1 Detyrimet për nën-huazim**

<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Detyrimet për hua afatgjate	2,147,607	0.00
<b>Total</b>	<b>2,147,607</b>	<b>0.00</b>

Ndërmarrja ka pranuar një nën-huazim nga Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës me të cilën edhe është nënshkruar marrëveshja e nën-huazimit me titull: "Vital Infrastructure Emergency Liquidity Loan" (e përkthyer në Gjuhën Shqipe: Kredi për likuiditet emergjent për infrastrukturën vitale) në shumën 2,147,607 euro. Dhe me këtë plan të amorizimit:

<b>Nr.</b>	<b>Datat e pagesës së këstëve të nën-huazimit</b>	<b>Kryegjësja</b>
1	16 Tetor 2023	536,902
2	16 Prill 2024	536,902
3	16 Tetor 2024	536,902

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

4	16 Prill 2025	536,902
		<b>2,147,607</b>

**16. Të hyrat e shtyra**

<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Te hyrat e shtyra	93,569	85,796
<b>Total</b>	<b>93,569</b>	<b>85,796</b>

Të hyrat e shtyra paraqesin Donacionet/Grantet/Subvencionet e dhena nga Ministrite, Qeveria dhe Ambasada Zvicerane te cilat jane trajtuar sipas SNK 20 si dhe parapagimet e klienteve te filatelise. Ndërmarrja është mbështetur financiarisht nga Ministria e Ekonomisë së Republikës së Kosovës respektivisht Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë në fund të vitit 2022 në shumën 73,500.00 euro për realizimin e projektit kapital "Renovimi i çatave të objekteve të Postës së Kosovës Sh.A., në formë bashkëfinanciami për rritjen e eficiencës së energjisë dhe përmirësimin e kushteve të punës.

Vlera financiare 73,500.- euro e financuar si formë e subvencionit do të njihet në pasurinë e ndërmarrjes si asete jo qarkulluese dhe do të zhvlerësohen në baza mujore, ku subvencioni do të njihet si të hyra jo operative ndërsa zvlerësimi në shpezimet e zhvlerësimit me kosto historike me çrast do të bëhet barazimi mes të hyrave dhe shpenzimeve.

**17. Të hyrat nga shitjet**

<b>Per vitin qe perfundon me 31 dhjetor</b>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Te hyrat nga shëbimet tjera postare	32,817	37,495
Te hyrat nga shërbimet postare- Blerjet online	7,385	28,879
Te hyrat nga shërbimet filatelike	166,821	152,451
Te hyrat nga shërbimet e konsumit me medhenje-pv	1,989,789	1,700,856
Te hyrat nga Posta Hibride	132,616	262,861
Të hyrat nga shërbimet financiare jobankare	1,971,373	1,985,103
Te hyrat nga posta nderkombetare	784,362	936,849
Te hyrat nga marveshja me Telekomin	819,878	846,376
Te hyrat nga qiraja	4,198,001	4,216,566
Te hyrat operative	11,832	10,938
Te hyrat jooperative	215,629	338,236
<b>Total te hyrat</b>	<b>10,330,503</b>	<b>10,516,609</b>

**18. KMSH**

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

Per vitin qe perfundon me 31 dhjetor	2022	2021
Kosto direkte të shitjes	274,741	309,065
Kosto të materialit	53,335	78,204
<b>Total</b>	<b>328,076</b>	<b>387,269</b>

**19. Shpenzimet operative**

Per vitin qe perfundon me 31 dhjetor	2022	2021
Shërbime publike	226,789	187,956
Ndalesa tatimore	112,812	96,806
Mirëmbajtje	449,871	410,947
Shpenzime të udhëtimit	909	60
Nafta dhe derivatet e saj	189,608	130,576
Shpenzime të qirasë	45,948	432,380
Shpenzime të zyres dhe administratës	171,369	169,987
Shpenzime jo- operative	382,904	446,517
Reprezentacioni/Kontigjenta	627	1,375
Të tjera	13,181	9,513
<b>Total</b>	<b>1,594,017</b>	<b>1,886,116</b>

Krahasuar me vitin paraprak shpenzimet e qirase jane me te uleta si rrjedhoje e ndryshimeve te trajtimit te tatimit ne burim per qira dhe ne kete vit paraqesin vetem shpenzimet per qira ku PK eshte qiramarres.

**20. Shpenzimet e pagave**

Per vitin qe perfundon me 31 dhjetor	2022	2021
Shpenzimet e pagave	4,341,641	4,470,076
Shpenzimet e pagave-kompensim per SHUP	3,655,569	3,559,084
Kontributet pensionale 5%	217,323	404,291
Shpenzime per pensionet	12,389	18,815
<b>Total</b>	<b>8,226,922</b>	<b>8,492,266</b>

**21. Transaksionet me palët e lidhura**

Një person ose një palë e afërt e familjes së atij personi është e lidhur me Kompaninë raportuese nëse ai person:

- i. ka kontroll ose kontroll të përbashkët mbi Kompaninë raportuese;  
ka kontroll ose kontroll të përbashkët të Kompanisë raportuese;
- ii. ka ndikim të rëndësishme mbi Kompaninë raportuese; ose
- iii. është anëtar i menaxhmentit kyq të Kompaninë raportuese ose mëmë të Kompanisë raportuese.

Një entitet është i lidhur me Kompaninë raportuese nëse ndonjë prej kushteve të mëposhtme aplikohet:

- i. Entiteti dhe Kompania raportuese janë anëtare të të njëjtit grup (që do të thotë që çdo entitet mëmë, filiale dhe degë filiale është e lidhur me të tjerët).

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

- ii. Entiteti është shoqëri ose ndërmarrje e përbashkët e entitetit tjetër (ose një shoqëri apo ndërmarrje e përbashkët e një anëtar i grupit në të cilën shoqëria tjetër është anëtar).
- iii. Të dyja entitetet janë ndërmarrje të përbashkëta të së njëjtës palë të tretë.
- iv. Njëri entitet është ndërmarrje e përbashkët e e pales së tretë dhe entiteti tjetër është shoqëri e entitetit të tretë.
- v. Entiteti është një plan përfitimi pas punësimit për përfitimet e punëtorëve të entitetit raportues ose një entiteti të lidhur me entitetin raportues. Nëse entiteti raportues është një plan I tille, punëtorët sponsorues janë gjithashtu të lidhur me entitetin raportues.
- vi. Entiteti është i kontrolluar ose ka kontroll të përbashkët nga një person i afërt ose një anëtar i afërt i familjes së atij personi.
- vii. Një person i lidhur ka ndikim të rëndësishëm mbi entitetin ose është anëtar i menaxhmentit kyq të entitetit (ose Kompanisë mëmë të entitetit).

Një transaksion me një palë të lidhur është një transfer i resurseve, shërbimeve ose obligimeve mes Kompanisë raportuese dhe një pale të lidhur, pavarësisht nëse çmimi është ngarkuar.

Gjatë vitit Kompania kishte transaksione me palët e ndërlidhura si me menaxhmentin kryesor dhe Bordin e Drejtoreve.

Më 31 Dhjetor	2022	2021
Kompenzimi për Bordin e Drejtoreve	47,350	30,166
Kryeshefi ekzekutiv	75,780	92,380

## 22. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

### a. Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Kompania e menaxhon kapitalin e vet për të siguruar që Kompania do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijimësisë, duke maksimizuar kthimin të aksionarët nëpërmjet optimizimit të borxhit dhe bilancit të kapitalit. Struktura e kapitalit të Kompanisë përbëhet nga kapitali që i atribuohet mbajtësve të kapitalit i dhe që përbëhet nga kapitali i emtuar dhe fitimet e mbajtura.

### b. Politikat e rëndësishme kontabël

Detajet e politikave të rëndësishme kontabël dhe metodat e miratuara duke i përfshirë edhe kriteret e njohjes, bazat e matjes dhe bazat mbi të cilat të ardhurat dhe shpenzimet janë njohur në lidhje me çdo klasë të pasurive financiare, detyrimeve financiare dhe instrumentet e kapitalit janë paraqitur në shënimin 4 të pasqyrave financiare.

### c. Kategoritë e instrumenteve financiare

Në fund të vitit Kompania ka këto instrumente financiare:

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
<u>Pasuritë Financiare:</u>		
Paraja e gatshme në dorë dhe bankë	2,427,815	1,334,931
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	2,120,967	2,392,505
Parapagimet për tatime	406,396	
<u>Detyrimet financiare në koston e amortizuar</u>	1,646,209	2,910,199

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
Të gjitha shumat në Euro

**d. Objektivat e menaxhimit të rrezikut financiar**

Aktivitetet e Kompanisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie të rreziqeve financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë dhe rreziqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të Kompanisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon t'i minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancat e biznesit të Kompanisë.

Menaxhimi i rrezikut zbatohet nga Bordi i Drejtorëve bazuar në politikat dhe procedurat e caktuara të aprovuara paraprakisht në formë të shkruar, dhe të cilat mbulojnë menaxhimin e rrezikut në përgjithësi, e po ashtu edhe fushat e specifikuar siç janë: rreziku i këmbimit valutor, rreziku i normave të interesit, rreziku i kredive, përdorimi i letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimet e likuiditetit tepricë.

**e. Rreziku i tregut**

*Rreziku i valutës së huaj*

Kompania operon ndërkombëtarisht dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor që rrjedh nga ekspozimet e valutave të ndryshme kryesisht nga Dollari Amerikan. Kompania nuk përdorë asnjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i këmbimit valutor. Thesari i Kompanisë është përgjegjës për të mbajtur pozitën adekuate neto në çdo valutë dhe në total dhe operacionet e saj janë të monitoruara çdo ditë nga drejtuesit e Kompanisë.

Kompania kryen transaksione edhe në Euro dhe në valuta të huaja. Kompania nuk ka hyrë në ndonjë shkëmbim forard ose nuk është përfshirë në transaksione derivateve gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2022 dhe 2021.

*Rreziku i normës së interesit*

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturiteti i pasurive që bartin interes të ndryshojë nga maturiteti i detyrimeve që bartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto pasuri. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar tregon deri në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Kompania nuk është ekspozuar dukshëm ndaj rrezikut të normës së interesit pasi që nuk ka ndonjë detyrim që bart interes të luhatshëm në datën e raportimit.

**f. Rreziku i kredisë**

Kompania është subjekt ndaj rrezikut të kredisë nëpërmjet aktiviteteve shitëse. Për këtë arsye, rreziku i kredisë për Kompaninë buron nga pamundësia e palëve për t'i përmbushur obligimet e tyre kontraktuese. Shuma e ekspozimit kreditor në lidhje me këtë paraqitet nga vlerat bartëse të pasurive në pasqyrën e pozicionit financiar.

Ekspozimi maksimal i rrezikut kreditor është shpalosur në Shënimin 22 c). Të arkëtueshmet tregtare monitorohen në baza ditore dhe klientët paralajmërohen me kohë.

Vlera bartëse e pasurive financiare të regjistruara në pasqyrat financiare, e cila është vlera neto nga humbjet nga dëmtimit, nëse ka ndonjë, përfaqëson ekspozimin maksimal të Kompanisë ndaj rrezikut të kredisë.

**g. Rreziku i likuiditetit**

Menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e parave të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet afatshkurta dhe financiare në mënyrë që të ndihmojë në arritjen e qëllimeve të kompanisë. Qëllimi i menaxhimit të likuiditetit është të ruajë fleksibilitetin duke ruajtur disponueshmërinë për të përmbushur detyrimet dhe për të siguruar fleksibilitet financiar. Gjatë vitit 2022 ndërmarrja ka gjeneruar para të mjaftueshme për të siguruar aftësinë paguese dhe fleksibilitet financiar. Me ç'rast ka mbajtur në kontinuitet detyrimet rrjedhëse në afatet Ligjore për t'u paguar.

Në krahasim me vitet e kaluara në vitin 2022 fluksi i parasë ishte i qëndrueshëm, kjo nga menaxhimi i mirë i parasë si dhe marrje e nën-huazimit.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
*Të gjitha shumat në Euro*

**h. Hipoteza e vijimësisë**

Kompania ka vlerësuar si risk faktin që të hyrat nga qiraja dhe shërbimet tjera që përfshin rreth 40% të të hyrave të përgjithshme janë nga partneri strategjik dhe të cilat mund të ndikojnë në vijimësinë financiare të ndërmarrjes. Mirëpo menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve ka planifikuar alternativa të tjera (si p.sh. dhënja me qera e hapësirave të lira të objekteve klientëve të tjerë, etj) në rast të pamundësisë së inkasimit të kërkesave nga ky partner strategjik. Gjithashtu edhe duke zgjeruar lidhjen e kontratave të reja afariste me pale të tjera për shërbime postare dhe financiare jo-bankare.

Kompania ka hartuar strategjinë e vijimësisë financiare të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve ku parashihen gjenerimi i të hyrave shtesë nga lansimi i dy projekteve të reja: 1. Terminali Doganor i mallrave dhe 2. Post Banka.

Për detaje më të hollësishme të planit të vijimësisë mund të referohet në strategjinë e vijimësisë financiare ku janë përshkruar mjaftueshëm ngjarjet që do të rezultojnë në vijimësinë e ndërmarrjes në aspektin financiar.

Gjithashtu ndërmarrja ka pranuar një nën-huazim nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës me të cilën edhe është nënshkruar marrëveshja e nën-huazimit me titull: "Vital Infrastructure Emergency Liquidity Loan" (e përkthyer në Gjuhën Shqipe: Kredi për likuiditet emergjent për infrastrukturën vitale) në shumën 2,147,607 euro. Kjo kredi siguron vijimësinë financiare të ndërmarrjes.

**i. Rreziku Operacional**

Rreziqet operationale janë rreziqet e humbjeve të papritura të shkaktuara për shkak të ekzekutimit joadekuat ose të pasukseshëm të proceseve të brendshme, sjelljes jo të duhur të punonjësve, funksionimit joadekuat ose pasukseshëm të sistemit ose ngjarjeve të jashtme, duke përfshirë edhe rrezikun ligjor. Rreziqet operationale përfshijnë qeverisjen e korporatave, pajtueshmërinë me rregulloret dhe praktikën e biznesit, menaxhimin e resurseve njerëzore, sigurinë e mjedisit të punës, dështimet e sistemit, menaxhimin e të dhënave, aktivitetet e paautorizuara dhe ndërprerjen e punës. Menaxhimin dhe zbatimin e procesit, menaxhimin e rrezikut financiar, mashtrimet e brendshme dhe të jashtme dhe dëmet materiale, zhvillimi dhe administrimi i shërbimeve.

**j. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare**

Menaxhmenti i Kompanisë konsideron se vlerat bartëse të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto ose kosto të amortizuara në pasqyrat financiare, përafrojnë vlerat e tyre të drejta për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër.

Kompania ka bërë rivlerësimin e pronave dhe ndertesave nga kompania e licensume ku janë rrite vlera e asetëve për vlerën prej.

**23. Detyrimet kontingjente dhe zotimet**

***Detyrimet ndaj tatimeve***

Pasqyrat financiare dhe regjistrimet kontabël të kompanisë nuk janë audituar nga autoritetet e taksave për periudhën 01 janar 2022 – 31 dhjetor 2022 kështu që obligimet tatimore të Degës nuk mund të konsiderohen si të përfunduara.

***Çështjet gjyqësore***

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania është e përfshirë në kërkesat e ndryshme dhe veprimet juridike. Sipas menaxhmentit dhe këshillave të tyre ligjore dhe informacionet shpjeguese nga ta theksojmë se vlera e pretenduar e detyrimeve nga kontestet civile, permbarimore dhe kontestet nga punetoret është 791,824 euro. Ketu nuk është përfshirë edhe kontesti gjyqësor me Telekomin sa i përket furnizimit me Storage Server nga Data prognat pasi që është e përfshirë në PF. Po ashtu, kërkesat tona nga Kontestet Gjyqësore nga lëmia civile mbi bazën e padive për kompensim dëmi dhe tjera arrijnë vlerën e përafërt prej 5,269,583-euro prej të cilave 4,741,404-euro kanë të bëjnë për shërbimet e SHUP.

**POSTA E KOSOVËS SH.A.**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022  
*Të gjitha shumat në Euro*

**24. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera (përveç atyre të cekura edhe më lartë) pas datës së raportimit që do të kërkonin shpalosje në pasqyrat financiare të Kompanisë.

